



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2025:002979

Datë: 30.01.2025

Numri i dokumentit: 06788218

KPPP.nr.20/25

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Delta Security” SH.P.K., me NUI: 810325614, me seli në Prishtinë, rruga “Enver Maloku”, nr.108, kundër debitorit Republika e Kosovës – Komuna e Prishtinës, Kuvendi Komunal, me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.714/2024 të datës 20.12.2024, të Përmbartuesit Privat Emine Sherifi - Lubeniqi, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datë 30.01.2025, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit Republika e Kosovës – Komuna e Prishtinës, Kuvendi Komunal, i ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.714/2024 të datës 20.12.2024, të Përmbartuesit Privat Emine Sherifi - Lubeniqi.
- II. MBETET NË FUQI Urdhri Përmbartimor P.nr.714/2024 i datës 20.12.2024, i Përmbartuesit Privat Emine Sherifi - Lubeniqi.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Delta Security” SH.P.K., ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.714/2024 të datës 20.12.2024, me të cilin e ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm Faturës Nr.20578-265-001-24 të datës 24.10.2024, me të cilin ka detyruar debitorin që kreditorit t’ia paguaj borxhin në shumën prej 47,143.07 €, me kamatëvonesë sipas llogaritjes së ekspertit financiar, ashtu që përmbartimi të realizohet përmes bllokimit të xhironlogarive bankare, me regjistrimin, konfiskimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme në pronësi të debitorit deri në arritjen e borxhit në

tërësi, si dhe zbatimi i përmbartimit nga institucioni shtetëror të realizohet përmes transferimit nga llogaritë e debitorit nga thesari në llogarinë bankare të kreditorit, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbartimor me arsyetimin se është i pabazuar, i palejuar dhe i paqëndrueshëm. Ka deklaruar se, kreditori i ka bashkangjitur propozimit për përmbartim vetëm faturën e cila nuk i plotëson kushtet esenciale për të qenë objekt përmbartimi sipas nenit 22 lidhur me nenin 29 të LPP-së, përkatësisht fatura nuk është e nënshkruar nga dy palët por vetëm nga kreditori, nuk është cekur afati i pagesës dhe nuk dihet burimi i faturës. Gjykatës i ka propozuar që të aprovohet prapësimi i debitorit dhe të abrogohet urdhri për përmbartim P.nr.714/2024 i datës 20.12.2024.

Kreditori me përgjigje në prapësim, ka deklaruar se fatura si dokument i besueshëm është dorëzuar fizikisht me rastin e përmbartjes së obligimeve sipas marrëveshjes dhe fatura është pranuar dhe protokolluar dhe e njëjta është nënshkruar dhe vulosur nga persona përgjegjës të debitorit. Tutje ka shtuar se, kreditori i ka kryer shërbimet e sigurimit fizik në objektin e debitorit sipas marrëveshjes dhe kërkesa për përmbartim të borxhit është plotësisht në pajtim me dispozitat ligjore. Gjykatës i ka propozuar që të refuzoj si të pabazuar prapësimin e debitorit dhe të vërtetohet urdhri përmbartimor me të gjitha obligimet si në propozimin për përmbartim.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigja në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, e duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbartim, i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara, në përputhje me nenin 29 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshatshëm për përmbartim po qe*

se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “Kur propozimi për përbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.” dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm, sipas të cilit mund të caktohet përbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Në rastin konkret gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përbaruesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm përkatësisht Faturën Nr.20578-265-001-24 të datës 24.10.2024, e cila i përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par.3 të LPP-së, meqenëse në këtë faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë përshkruar punët dhe shërbimet që kanë qenë objekt i kësaj fature, si dhe është përcaktuar shuma e cila përbën detyrim për përmbushje nga ana e debitorit.

Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se në rastin konkret Fatura Nr. 20578-265-001-24 e datës 24.10.2024, i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP-së, për zbatimin e përbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që e njëjta është dorëzuar në origjinal, është pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, gjë e cila vërtetohet nga vula e protokollit të debitorit si dhe nuk është kontestuar asnjëherë nga debitori.

Në rastin konkret rezulton se Fatura Nr. 20578-265-001-24 në vlerën prej 47,143.07 €, është lëshuar nga ana e kreditorit me datë 24.10.2024 dhe e njëjta është pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, e cila vërtetohet nga vula e pranimit e datës 28.10.2024 dhe numri i protokollit 18-422/01-140911/24.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata lidhur me këtë çështje përbarimore, vlerëson se nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 par.1 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lartë, dhe duke u bazuar në nenin 73 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.20/25, datë 30.01.2025

Gjyqtarja

Verona Dibra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimin të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.